



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA VORË

Nr.....prot

Vorë, më ____/____/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Bashkia Vorë, Vorë

Për : “HMK Consulting” sh.p.k me Nipt L57129604Q

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Kolaudimi i punimeve në objektet e Bashkisë Vorë për vitin 2019 (Faza e III). Loti 5 “Kolaudim i punimeve për objektin “Rindërtim i Pasarelës së Fshatit Fushë Prezë, Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vorë”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-35258-09-09-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 30 ditë duke filluar nga momenti i fillimit të efekteve të kontratës së kolaudimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi në fushën e ndërtimeve.

Fondi limit: 30.875 lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Nga të ardhurat e Bashkisë Vorë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 20/09/2019, Ora:10:00.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Duke qenë se rezultuan dy oferta ekonomike me vlerë të njëjtë, konkretisht oferta ekonomike e “HMK Consulting” sh.p.k me vlerë të ofertës 28.500 (njëzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh dhe “Novatech Studio” sh.p.k me vlerë të ofertës 28.500 (njëzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 8, fituesi u përcaktua me short, si më poshtë:

Në vend të parë: “HMK Consulting” sh.p.k me Nipt L57129604Q

Në vend të dytë: “Novatech Studio” sh.p.k me Nipt L01717030C

Të skualifikuar:

1. M.A.K Studio me Nipt L01422017O, me vlerë të ofertës 26.860 (njëzetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh. Referuar VKM nr. 354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të arifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, oferta është nën kufirin minimal të lejuar. Duke qenë se nuk jemi në rastet e nenit 7, pika 3 të vendimit të sipërcituar, oferta nuk është e vlefshme.

2. Net Group me Nipt L72023002P, me vlerë të ofertës 28.500 (njëzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Mungon pika 2.1.2 - Certifikata ISO 14001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit).

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“HMK Consulting” sh.p.k me Nipt L57129604Q**, me vlerë të ofertës 28.500 (njëzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkia Vorë, Qyteti Vorë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e këtij publikimi, por në çdo rast subjekti është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës në zbatim të nenit 21 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15/10/2019.

Ankesa: NUK KA

Nëpunësi Autorizues

Agim KAJMAKU